

## **Biografia**

### **Të dhënat personale:**

Magjistër Vershic Ferdinand Kristijan (gjer. Mag. Wehrschütz Ferdinand Christian)

I lindur më 9.10.1961 në Grac;

Korrespondent i ORF-së për Ballkan dhe Ukrainë, paraprakisht redaktor i Departamentit për politikë të jashtme dhe i Redaksisë të lajmëve të televizionit; nga gushti deri në dhjetor to vitit 1999 ka qenë korrespondenti i tretë i ORF-së në Bruksel; paraprakisht ka qenë shtatë vjet në shërbimin e Departamentit të informimit të Redaksisë të lajmeve të radios (ORF).

Anëtarë shumëvjeçar i Institutit Ndërkombëtar për Studime Strategjike (IISS) dhe të Institutit Mbretëror të shërbimeve mbrojtëse (RUSI) në Londër;

Oficer i njësisë policore pranë ushtrisë: Grada major;

I martuar, bashkëshortja Elizabeta dhe vajzat Imanuela dhe Mihaela jetojnë dhe punojnë në Salzburg;

Njohuritë: e gjuhëve të huaja: anglisht, rusisht, gjuha ukrainase, serbisht (rrjedhshëm), frëngjisht (mirë), sllovenisht (mirë), maqedonisht (njohuri pasive, shumë mirë), shqip (bazë);

### **Karriera:**

Maturroi më 6. qershor të vitit 1980 në Grac;

1980–1981: trajnimi për oficer të njësi policore në ushtri; për disa vite ka punuar si oficeri për informim në “Terezianum”, një gjimnaz privat në Vjenë; grada e tashme: major; në vitin 1994 pjesëmarrja vullnetare në trajnimin e veçantë ushtarak në Grac, kurset e rusishtes dhe të gjuhës ukrainase për oficerë;

1981–1985: studimet në Fakultetin Filologjik dhe në Institutin për sllavistikë të Universitetit të Gracit;

1984: punë vullnetare katër javore në gazetën „Kleine Zeitung“, të përditshmen kryesore në Grac;

Nëntori 1985: fiton titullin e magjistrisë të drejtësisë; e mbron punimin e magistraturës: “Ligji për aksione si bazë analoge për rregullat për organizimin e sistemeve të bankave të kursimeve” („Das Aktiengesetz als Analogiebasis für das Sparkassenorganisationsrecht“);

1985–86: kurs bazë katër javor i gazetarisë, kursi i avancuar i gazetarisë;

korrik–tetor të vitit 1986: bursa e Fondacionit për Afrikën e Jugut (South Africa Foundation); puna pranë zyrës së avokatëve „Webber&Wentzel“ në Johannesburg;

1987: emërohet kryeredaktor i javores „Neue Freie Zeitung“;

mars–prill të vitit 1988: udhëtimi në Britaninë e Madhe dhe në Hungari me Klubin Austriak të Gazetarisë dhe kuratoriumin për edukimin e gazetarëve;

Korriku 1988: angazhman vullnetar katër javor në gazetën „Neue Zürcher Zeitung“ në departamentin për politikë të jashtme dhe ekonomi (që nga kjo kohë, recensione të rregullta shumëvjeçare në këtë gazetë në rubrikën “Libri politik”);

Shtatori i vitit 1988: udhëtimi njëjavor nëpër qendra të NATO-së në Bruksel, Frankfurt dhe Napoli me ftesë të ambasadës Amerikane;

Prilli 1989: udhëtimi katër ditor në Moskë, takimi me kryeredaktorin përgjegjës të gazetës „Известия“;

Qershori 1989: udhëtimi njëjavor në Libi me rast të njëzet vjetorit të revolucionit;

Tetori 1989: një javë qëndrimi në RDGJ (Republikën Demokratike të Gjermanisë) me rast të dyzet vjetorit të shtetësisë;

Prilli 1990: udhëtim informativ në Japoni me Klubin Austriak të Gazetarisë;

Tetori 1990: sesioni i Klubit politik të Berlinit (PKB) në Athinë mbi temën zgjerimi i BE-së për jug, politika ndaj Mesdheut, krahu jugor i NATO;

Nëntori 1990: sesioni i PKB-së në Paris në Institutin Francez për Marrëdhënie Ndërkombëtare (Institut Français des Relations Internationales) për pasojat e bashkimit të Gjermanisë ndaj politikës së sigurisë evropiane; udhëtimi informativ në Qipro për një javë, me ftesën e Qeverisë së Qiprosë;

Dhjetori 1990: sesioni i PKB-së mbi gjendjen e sigurisë në Evropë;

Janari 1991: udhëtim informativ në Hongkong, në kohëzgjatje prej një jave;

1 maj 1991: kalimi në ORF (redaksia e teletekstit);

1 janar 1992: kalimi në radio ORF, redaktor – drejtues emisioni për lajme nga bota dhe redaktor i programit Danubi i kaltër (Blue Danube)

Shkurti 1992: sesioni vjetor i Akademisë për Sigurim dhe Bashkëpunim (ASZE) në Berlin me temën Procesi i bashkimit evropian;

Prilli 1992: udhëtimi i parë informativ në Kiev;

Korrik–gusht 1992: (qëndrimi tre javor në Ukrainën jugore, punim i studimit për “Ukraina në rrugë për t’u bërë forcë rajonale në Evropën Lindore?”

Shtatori 1992: sesioni i ASZE në Sofje i dedikuar situatës në Ballkan;

Tetori 1992: këshillim në Institutin për Studime të Sigurisë së Bashkimit të Evropës Perëndimore në Paris mbi zhvillimin ushtarak-politik në Evropë me vështrim të veçantë mbi krizën në Jugosllavi;

Shkurti 1993: takimi vjetor i Akademisë për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë; tema: Siguria Evropiane;

Qershori 1993: kurs dyjavor i frëngjishtes në Cannes;

Gushti 1993: qëndrimi studimor katër javor në Donjeck (Ukraina e jugut) kurse të rusishtes dhe të gjuhës ukrainase;

Mars–prill 1994: kursi tre javor i gjuhës ukrainase në Ukrainën Perëndimore (Çernivci);

6.6.1994 – 16.9.1994: trajnim për përkthyes ushtarak për gjuhë ruse dhe ukrainase pranë ushtrisë austriake;

Gusht–shtatori 1995: qëndrimi i ri në Bukovinë, në kohëzgjatje prej tri jave;

22–23 janar 1996: pjesëmarrja në sesionin “Fondacioni për shkencë dhe politikë” (Stiftung für Wissenschaft und Politik) në Ebenhausen mbi politikën e jashtme ruse: e ka mbajtur një ligjëratë për marrëdhënie ruso – ukrainase;

Gusht 1996: ushtrimi vullnetar ushtarak pranë Ambasadës së Austrisë në Kiev;

20–21. janar 1997: pjesëmarrja në takimin “Fondacioni për shkencë dhe politikë” në Ebenhausen për interesat aktuale gjermane duke marrë parasysh ndryshimet në planin e politikës botërore (duke filluar nga zgjerimi i NATO-s në lindje deri te situata në Azinë Lindore), është mbajtur ligjëratë për stabilitetin e Ukrainës duke pasur parasysh intereset e kundërta evropiane dhe amerikane;

21.6.1997–17.8.1997: e ka ndjekur shkollën verore të ukrainistikës në Universitetin Harvard në SHBA;

10–14 shtator 1997: pjesëmarrja në sesionin vjetor të IISS në Singapor në temën Sfidat ndaj sigurisë nën dritën e avansimit të Pacifikut aziatik:

13.11.1997: ligjëratë rreth “Rolit të mediave në situatat e krizës ndërkombëtare” në kuadër të manifestimit të Akademisë për mbrojtje të vendit (si institucion më i lartë për edukim dhe punim hulumtues pranë ushtrisë austriake) me temë: “Forcat e armatosura dhe menaxhimi ndërkombëtar i krizave”;

14–21 nëntor 1997: me ftesën e “Qendrës për gazetari të pavarur”, një institucion të fondacionit Soros, qëndrimi në Moldavi. Në kryeqytetin e Moldavisë Kishnjev me këtë rast e ka mbajtur seminar për lajme në radio në të cilin kanë marrë pjesë 17 radio gazetarë.

24 nëntor 1997: moderimi i seminarit një ditë me temë politikën e sigurisë së Austrisë si dhe destinacionet ekonomike; organizatorët kanë qenë Akademia për Mbrojtje të vendit dhe Shoqata afariste Austriake.

Gushti 1998: punë një mujore në redaksinë e politikës së jashtme të radio së ORF;

Tetori 1998: udhëtimi një javor në Ukrainën Qendrore së bashku me drejtuesin e Misionit Qendror të Françeskanëve për Evropën Qendrore dhe Lindore: vizita në manastire françeskane dhe informimi për pozitën e kishave në Ukrainë (shtojcë për „Die Furche“);

25.10.1998–25.11.1998: bursa një mujore e Universitetit Djuk (Duke University) në Karolinën Veriore me ftesë të Fondacionit Amerikano – Austriak, e cila përfshinte edhe vizitë mediave në Nju Jork dhe Uashington);

20–23.12.1998: Vizitë e viktimave të përmytjes në Karpate të Ukrainës së bashku me drejtuesin e Misionit Qendror të Françeskanëve për Evropën Qendrore dhe Lindore (shtojcë për „Kleine Zeitung“);

Mars 1999: kursi dhjetëditor i hungarishtes në Berlic, Budapest;

Qershori 1999: kalimi në televizionin ORF; përgatitja për angazhman në pozitën e korrespondentit të tretë nga Brukseli, trajnimi një mujor në redaksinë e politikës së jashtme në lajmet „Zeit im Bild 1“ dhe „Zeit im Bild 2“;

29.6.1999: Prezantimi i studimit “Ukraina dhe Bashkimi Evropian” në kuadër të tryezës së rrumbullakët të mbajtur në Akademinë për Mbrojtjen e Vendit;

Nga fundi i gushtit deri në fillimin të dhjetorit të vitit 1999: korrespondenti i tretë në Bruksel, vizita të shumta Parlamentit Evropian në Strazburg dhe udhëtime në Luksemburg (Gjykata Evropiane e

Drejtësisë, sesionet e Këshillit të Ministrave të BE-së, sesionet e Ministrave të Punëve të Jashtme dhe të Mbrojtës së Bashkimit të Evropës Perëndimore); gjithsej janë përpiluar 15 transmetime për TV e 65 për radio;

6–7.12.1999: seminar intensiv në Akademinë për Mbrojtën e Vendit për oficerë për gjuhë të huaja më temë analiza e lajmeve; pjesëmarrja në cilësi të ligjëruesit jo-rezident me ligjëratë mbi korrespondencën mediatike dhe atë luftarake në radio dhe televizionin ORF;

31.1.2000: Ligjeratë mbi temën “Rusia në prag të zgjedhjeve presidenciale” ftesa e Unionit të njësishë policore të Shtajerskës;

Dhjetori 1999: provizorisht i emëruar për postin e shefit të Zyrës së ORF-së në Beograd; 14.2.2000: se pari udhëtimi zyrtar në Beograd sipas urdhrit të ORF-së dhe marrja e zyrës; 1.5.2000: i emëruar për korrespondent të ORF-së në Beograd;

Maj–qershor 2003: qëndrimi tre javor në Tiranë, kursi intensiv i shqipes;

Në përshkrimin e veprimtarive të shefit të zyrës dhe korrespondentit përfshihet raportimi për Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni Kosovë dhe për vende në rajon. Kjo nënkupton edhe udhëheqjen e zyrës së ORF-së në Beograd. Në momentin e vendosjes në këtë detyrë, pozita e dhënë, duke i pasur parasysh rrethanat politike në Serbi, ka qenë e zbrazët. Është dashur të zbatohet riorganizimi i plotë i zyrës në Beograd si dhe të ndërtohet infrastruktura e gazetarisë e plotë në Shqipëri dhe në shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë. Për shembull kjo nënkupton bisedimet për të gjithë kontratat mbi qiramarrje ose kontrata pune.

23–31. Janar 2014: angazhimi i veçantë në Kiev me rast të trazirave në Ukrainë.

Nga mesi i shkurtit të vitit 2014: Ka raportuar nga vatrën më të mëdha në Ukrainë, duke i përfshirë edhe Krimenë dhe zonën e Donjeckut (Donbas) gjatë luftës.

Në vjeshtë të vitit 2014 është emëruar për korrespondent të parë të Televizionit Austriak për territorin e Ukrainës me seli në Kiev.

Momentalisht është shef i zyrës për Ukrainë dhe Ballkan.

Tetor, 11-18 / 2017 - Vëzhgues afatshkurtër zgjedhjesh për OSBE-në në Kirgistan

Qershor, 12 -15 / 2017 - Pjesëmarrje në një Panel-Diskutimi në ASTANA të Kazakistanit, organizuar nga Dhoma Ekonomike Austriake (Intervistë me Ministrin e Jashtëm)

Prill, 1 - 6/2018 - Turkmenistan, Përgatitje e gazetarëve të rinj dhe diplomatëve se si të mund t'i organizojnë vizitat shtetërore

#### **Publikimet:**

Mag.Kristijan Vehrshic i ka shkruar tre libra:

2009: „Në vijën e zjarrit – Ballkani mes Brukselit dhe Beogradit” („Im Kreuzfeuer – Am Balkan zwischen Brüssel und Belgrad”);

2013: „Vatra Ballkan – e kaluara e përgjakur – e ardhmja e pasigurt” („ Brennpunkt Balkan – Blutige Vergangenheit – ungewisse Zukunft“);

2014: „Vatra Ukraina – bisedat për vendin e ndarë” („Brennpunkt Ukraine – Gespräche über ein gespaltenes Land“);

Ka marrë pjesë në publikimin e dy librave, të cilët i kanë shkruar të gjithë korrespondentët e Televizionit Austriak;

Publikon artikuj mbi tema shoqërore, të politikës së jashtme, të sigurisë dhe media -- politike nëpër gazeta të shumta „Neue Zürcher Zeitung“ (si komentator mysafir skruan shtojca mbi situatën në Ukrainë dhe Rusi; Recenzione të librave politike nga Austria), „Presse“, gazeta ushtarake austriake

„ÖMZ“, në gazetat „Standard“ dhe „Defence National“, në javoren ukrainase „Молодий буковинець“, magazinën „Wiener Journal“. Nga momenti i vendosjes së tij për korrespondent të ORF-së rregullisht raporton mbi ish Jugosllavinë për „Kleine Zeitung“ dhe „Wiener Zeitung“. Kësaj duhet t'i shtohen edhe ligjëratat e shumta në Austri mbi situatën në ish Jugosllavi dhe ngjarjet e shumta të dedikuara Ballkanit dhe Ukrainës.

**Çmimet dhe mirënjohjet:**

Çmimi shtetëror austriak për arritjet publicistike në interesin e mbrojtjes shpirtërore të vendit ( i ndarë në tetor të vitit 2000 nga Ministria Federale e Austrisë për Edukim, Shkencë dhe Kulturë);

Çmimi për shtyp Leopold Kunshak (i ndarë në mars të vitit 2007);

2012: së bashku me korrespondentët e tjerë të ORF-së e ka marrë çmimin e veçantë „Romy“ të gazetës austriake „Kurier“ për punë jashtë vendit;

2014: i nominuar për „Romy“ për punë në Ukrainë;

2014: e fiton mirënjohjen “Gazetar i vitit” për raportim luftarak nga Ukraina.